

Paramahansa Jogananda

Rubaijat e Omar Khajamit

interpretim shpirtëror

nga përkthimi i Edward FitzGerald-it

i 25 Rubaijat-eve (katërvargësheve) të para

zgjedhi dhe shqipëroi Ridvan Bunjaku

shtator-tetor 2023

Përmbajtja

Rubaijat e Omar Khajamit (me interpretime).....	4
1	4
2	5
3	6
4	7
5	8
6	9
7	10
8	11
9	12
10	13
11	14
12	15
13	16
14	17
15	18
16	19
17	20
18	21
19	22
20	23
21	24
22	25
23	26
24	27
25	28

Rubaijat e Omar Khajamit

Rubaijat e Omar Khajamit (vetëm vargjet).....	29
1	29
2	29
3	29
4	30
5	30
6	30
7	31
8	31
9	31
10	32
11	32
12	32
13	33
14	33
15	33
16	34
17	34
18	34
19	35
20	35
21	35
22	36
23	36
24	36
25	37
Për botimin	38
Bibliografia	38
Online	38
Licensimi	38

Rubaijat e Omar Khajamit (me interpretime)

1

Zgjoheu! se Mëngjesi në Tasin e Natës

E hodhi Gurin që i nis Yjet në Fluturim:

Dhe Shih! Gjuetari i Lindjes e kapi

Frëngjinë e Sulltanit në një Lak të Dritës.

FJALOR:

Mëngjesi: Agu i zgjimit nga ekzistenca tokësore deluzive.

Tasi i natës: Terri i injorancës, që e burgos shpirtin e pavdekshëm në vetëdije të vdekshme.

Guri: Disiplina shpirtërore.

Yjet: Vezullimi tërheqës i merakeve materiale.

Gjuetari i Lindjes: Urtia lindore, vrasës i fuqishëm i deluzionit.

Frëngjia (dritarja) e Sulltanit: Shpirti sovran.

Laku i dritës: Ndriçimi shpirtëror i urtisë, që e shkatërron terrin robërues që e rrethon shpirtin.

2

Gjersa ëndërroja kur Dora e Majtë e Agut ishte në Qiell

E ndjeva një Zë brenda Tavernës duke klithur:

“Zgjohuni, Të Vegjlit e mi, dhe mbusheni Kupën

Para se të thahet Rakia e Jetës në Kupën e vet.”

FJALOR:

Dora e Majtë e Agut: Agu i urtisë së hershme, etja e parë për ta zgjidhur misterin e jetës.

Një Zë: Intuita e shpirtit.

Taverna: Vendi i shenjtë i qetësisë së brendshme.

Të Vegjlit: Mendimet e pazhvilluara, intuitat më të hershme të destinimit të jetës.

Mbusheni Kupën: Mbusheni vetëdijen.

Rakia e jetës: Gjallëria e jetës.

Kupa e vet: Trupi i njeriut.

Thahet: Shuhet.

3

Dhe, gjersa Gjeli këndoi, ata që rrinin

Para Tavernës bërtitën: “Hape pra Derën!

Ti e di sa pak na duhet të rrimë,

Dhe, kur të largohemi, mund të mos kthehemi më.”

FJALOR:

Gjeli: Urtia.

Taverna: Jeta trupore.

Dera: Portali i qetësisë së brendshme.

Pak na duhet të rrimë: Koha e shkurtër e jetës trupore.

Kur të largohemi: Kur ta kemi lënë këtë tokë përgjithmonë, pas arritjes së urtisë.

Mund të mos kthehemi më: Nuk duhet të rimishërohemi më kurrë.

*Tash Viti i Ri duke i ringjallur Meraket e vjetra,
Shpirti i zhytur në mendime kalon në Vetmi të Këndshme,
Ku Dora e Bardhë e Musait¹ në Degën Kryesore
Shfaqet, dhe Isai² nga Toka psherëtin.*

FJALOR:

Viti i Ri: Agu i ri i urtisë.

Meraket e vjetra: Etja epokale e shpirtit individual në kërkim të Shpirtit Hyjnor.

Shpirti i zhytur në mendime: Shpirti individual që arsyeton dhe e dallon të mirën nga e keqja.³

Vetmia e Këndshme: Qetësia e brendshme e vetëdijes shpirtërore.

Dora e Bardhë: Vetëdija e pastruar.

Toka: Deluzioni kozmik i vdekshmërisë.

¹ Moisiut

² Jezusi

³ Për të qenë të saktë, shpirti individual, duke qenë pasqyrim i pastër i Shpirtit Hyjnor, është i gjithëdijshëm dhe nuk ka nevojë të arsyetojë apo ta dallojë të mirën nga e keqja. Por gjatë mishërimit, shpirti individual e merr deluzionin e ndarjes nga Shpirti Hyjnor; gjersa urtia nis të agojë në njeriun përmes evolucionit natyror ngritës të arsyes dhe dallimit të të mirës nga e keqja, zotësia e gjithëdijshme e shpirtit individual e intuitës i nxit dhe i drejton këto fuqi përbrenda, për ta zbuluar intuitivisht prezencën e përhershme të Shpirtit Hyjnor.

*Irami vërtet është zhdukur me gjithë Trëndafilin e tij,
Dhe Kupa me Shtatë Unaza e Xhemshidit ku askush s'di;
Por prapë Hardhia e jep Rubinin e saj të lashtë,
Dhe prapë një Kopsht skaj Ujit fryn.*

FJALOR:

Irami: Gjendja e jashtme, apo e vetëdijshe me shqisa, e mendjes dhe jetës së njeriut.

Trëndafili: Kënaqësitë e përkohshme shqisore.

Kupa me Shtatë Unaza: Ena cerebrospinale (tru-shpinore) me shtatë qendrat e saj (si unaza) të vetëdijes dhe të jetës. Përmes këtyre shtatë pleksuseve (rrjeteve nervore) jeta dhe vetëdija e shpirtit zbresin nga Shpirti në kufizimet e trupit, dhe duhet që përfundimisht të ngriten në lirinë e Pafundësisë.⁴

Xhemshidi: Vetëdija mbretërore e shpirtit për Pafundësinë.

Ku askush s'di: Personi mesatar është i pavetëdijsëm për ekzistencën e qendrave kurrizore dhe për rëndësinë e tyre shpirtërore.

Hardhia: Shpirti hyjnor.

Rubini i lashtë: Lumturia e lashtë e shpirtit (kokrrat e rrushta apo “të rubinta” të hardhisë-shpirtërore).

Kopshti: Realizimi i (rrokja e, kuptimi i) vetes që lulëzon me cilësitë shpirtërore.

Uji: Urtia.

⁴ Librat mësimorë jogikë i përkufizojnë shtatë qendrat shpirtërore si *çakrat* (rrotat) apo *padmat* (lotuset, zambakët e ujit), “spicat” apo “petalet” nga të cilat rrezatohet jetë dhe vetëdije në trup. Shpirti – Shpirti suprem, jeta dhe vetëdija në njeriun – rri në më të lartin nga këto qendra në tru, në vetëdijen kozmike.

Gjersa vetëdija dhe jeta e shpirtit zbresin në shtyllën kurrizore dhe nga *çakrat* në trupin fizik dhe shqisat, perceptimet e tij bëhen gjithnjë e më të pakëndshme deri kur përfundimisht, në gjendjen me vetëdije shqisore, shpirti, si ego, identifikohet plotësisht me formën fizike që e kufizon përreth dhe mënyrat (modet) e tij të kufizuara të perceptimit dhe të shprehjes.

Përndritja shpirtërore qëndron në tërheqjen (ngrehjen) e vetëdijes nga gjendjet më të pakëndshme të perceptimit kah qendrat më të larta shpirtërore në shpinë dhe në tru. Efekti është Vetë-realizimi (kuptimi, rrokja e vetes), apo realizimi i (rrokja e) vetes së vërtetë si Shpirt Hyjnor, i bërë sipas konceptit apo shëmbëlltyrës së Zotit, me tërë cilësitë E Tij hyjnore, duke mbretëruar në mënyrë supreme në gëzim e urti mbi mbretërinë e trupit si dhe mbi mbretërinë qiellore përbrenda.

6

*Dhe Buzët e Dautit⁵ janë të mbyllura; por në hyjnoren
Pehlevi në fyellin zëhollë, me “Verë! Verë! Verë!
Verë të Kuqe!” – Bilbili i klith Trëndafilin
Atë Faqen e tij të verdhë ta skuqë.*

FJALOR:

Buzët e Dautit janë të mbyllura: Zëri i Pafundësisë është i heshtur përjashta.

Pehlevi në fyellin zëhollë: Gjuha e admirueshme e urtisë hyjnore. Siç është Pehlevi (Pahlavi) – gjuha e epokës heroike të Persisë, ashtu është urtia hyjnore – gjuha e Pafundësisë.

Vera e Kuqe: Lumturia hyjnore shpirtërisht gjallëruese.

Bilbili: Intuita. Siç e argëton bilbili njeriun me këngë gjatë natës, ashtu në errësirën e qetësisë së brendshme, ku turbullohen të gjitha fenomenet materiale, e vërteta këndon përmes intuitës së të devotshmit.

Trëndafilin me faqen e verdhë: Merakuesi shpirtëror, dikur me faqe të shëndetshme rozë dhe entuziast, jeta e të cilit është zbehur nga ashpërsia e vetëdisiplinës dhe e vetëmohimit.

Ta skuqë: Ta bëjë thellësisht të kuqe apo ta gjallërojë jetën me lumturi hyjnore.

⁵ Davidit

7

Eja, mbushe Kupën, dhe në Zjarrin e Pranverës

Hidhe Rrobën Dimërore të Pendimit:

Zogu i Kohës ka veç pak rrugë

Të fluturojë – dhe Shih! Zogu është në Krah.

FJALOR:

Mbushe Kupën: Mbushe vetëdijen tënde.

Zjarri i Pranverës: Ngrohtësia e entuziazmit shpirtëror.

Rroba Dimërore e Pendimit: Pishmani që e ngrin lumturinë shpirtërore, i cili e pason kënaqësinë shqisore.

Zogu i Kohës: Jeta njerëzore që është kalimtare (fluturon) dhe në ndryshim të vazhdueshëm.

Veç pak rrugë të fluturojë: Veç pak kohë mbetet.

Zogu është në Krah: Jeta po fluturon pa ndonjë destinim të caktuar.

Dhe shiko – një mijë Lulëzime me Ditën

U zgjuan – dhe një mijë u shpërhapën në Argjilë:

Dhe ky Muaj i parë i Verës që e sjell Trëndafilin

Do ta largojë Xhemshidin dhe Kaikobadin.

FJALOR:

Lulëzimet: Cilësitë e mira dhe të këqija që lulëzojnë brenda dhe përreth shpirtit.

Dita: Zgjimi i urtisë.

U zgjuan: U manifestuan.

Muaji i parë i Verës: Zelli (zjarri, vrulli) shpirtëror, dhe ekstaza (lumturia e madhe) e meditimit të thellë.

Trëndafili: Realizimi i (rrokja e, kuptimi i) vetes.

Xhemshidi dhe Kaikobadi: Sovraniteti shpirtëror i shpirtrave të realizuar.

Por eja me Khajamin e vjetër, dhe lëre Turmën

E Kaikobadit dhe Kaikhosruit të harruar:

Le të shtrihet Rustumi përreth si të dojë

Ose Hatim Tai le ta qajë Darkën – mos ua vër veshin.

FJALOR:

Khajami i vjetër: Urtia e lashtë që e sjell çlirimin e shpirtit.

Kaikobadi dhe Kaikhosru: Shpirtra të harruar dikur të mishëruar në tokë.

Rustumi: Shpirt potencialisht i madh që e çon jetën dëm në kënaqësi të përkohshme.

Hatim Tai: Njeriu me mendje tokësore që i ndjek me synim detyrat e zakonshme.

Ta qajë Darkën: Lidhja e pavëmendshme me aktivitetet materiale.

10

*Me mua përgjatë një Rripi të Barishteve të shkapërderdhura
Që veç e ndan shkretëtirën nga të mbjellat,
Ku emri i Skllavit dhe Sulltanit njihet pak,
Dhe Sulltan Mahmudi i shkretë në Fronin e tij.*

FJALOR:

Rripi i Barishteve: Pjesë e ngushtë e mbivetëdijes, urtia gjithnjë e re e shpirtit, e fshehur ndërmjet nënvetëdijes dhe vetëdijes së zgjuar.

E ndan: E veçon në mënyrë subtile.

Shkretëtira: Mendja e shkretë e nënvetëdijshme, ku përjetimet e freskëta ditore të mendjes së vetëdijshme humben dhe futen nën dhe.

Të mbjellat: Atmosfera e qytetërimit material e kultivuar nga mendja e vetëdijshme.

Skllavi: I nënshtruar ndaj instinkteve, iluzioneve dhe shpërqendrimeve të mendjes së nënvetëdijshme.

Sulltani: Vetëdija materiale e zhvilluar fuqishëm.

Sulltan Mahmudi i shkretë në Fronin e tij: Ndjeje dhembshurinë për ata që më kot e kërkojnë lumturinë në pushtetin e përkohshëm.

*Këtu me një Copë Buke nën Degën Kryesore,
Një Shishe me Verë, Një Libër me Vargje – dhe Ti
Pranë meje duke kënduar në Tokë të Egër –
Dhe Toka e Egër është Parajsë e mjaftueshme.*

FJALOR:

Buka: Prana, apo forca e jetës (energja kozmike e jetës).

Nën Degën Kryesore: Me vëmendje të përqendruar përbrenda në pemën cerebrospinale (tru-shpinore) të vetëdijes (trungu i së cilës është rruga pranike e jetës në trup, dhe degët e së cilës janë sistemi nervor).

Vera: Dehja-me-Zotin; lumturia e dashurisë hyjnore që vjen kur njeriu shkrihet me Zotin në meditim.

Një Libër me Vargje: Frymëzime të dashurisë hyjnore që burojnë nga zemra.

Ti: Zoti, I Dashuri Kozmik.

Duke kënduar: Duke u argëtuar me perceptime intuitive të të vërtetës sublime.

Në Tokë të Egër: Në qetësinë e brendshme, ku janë larguar turmat e mendimeve shqetësuese.

Toka e Egër është Parajsë: Vetmia fillestare e ndjerë në qetësinë e meditimit të thellë, për shkak të mungesës së mendimeve shqetësuese, bëhet parajsë për të devotshmin kur ai e zbulon aty lumturinë e mrekullueshme qiellore të Zotit.

12

“Sa i ëmbël që është Sovraniteti i vdekshëm!” – mendojnë disa

Të tjerë – “Sa e bekuar Parajsa që po vjen!”

Ah, merri Paratë në dorë dhe hiq dorë nga Të Tjerat;

Oh, Muzika trime e Daullës së largët!

FJALOR:

Sovraniteti i vdekshëm: Pushtetet apo fuqitë e përkohshme materiale.

Parajsa që po vjen: Shpresa e pasigurt për lumturinë në të ardhmen.

Paratë në dorë: Pasuria e qasshme e shpirtit të pashkatërrueshëm dhe lumturia hyjnore gjithmonë e re që gjendet në meditim.

Muzika trime: Mendimet e gëzueshme të pritshmërisë konfidente.

Daullja e largët: Shpresa e sigurt e suksesit në të ardhmen që vjen me të jetuarit drejt duke e fituar urtinë së pari.

13

*Shikoje Trëndafilin që fryn rreth nesh – “Shih,
Unë duke qeshur,” thotë ai, “në Botë fryj:
Menjëherë Xhufka e mëndafshtë e Çantës sime
Shkulet, dhe Thesari i saj hidhet në Kopsht.”*

FJALOR:

Shikoje: Analizoje.

Trëndafili që fryn rreth nesh: Kënaqësitë materiale që na rrethojnë.

Duke qeshur në Botë fryj: Duke u tallur, në çdo fllad e fluturoj butësisht tundimin e kënaqësive shqisore.

Xhufka e mëndafshtë e Çantës sime: Ngjitja me shqisat, që e lidh njeriun me përjetimet tokësore.

Shkulet: Shkëputet nga urtia.

Thesari i saj në Kopsht hidhet: Gjuhen kënaqësitë false të saj në tokë.

14

*Shpresa Tokësore në të cilën burrat i vendosin Zemrat
Shndërrohet në Hi – apo përparon; dhe së shpejti,
Si Bora mbi Fytyrën e pluhurosur të Shkretëtirës
Duke ndriçuar një Orë të vockël a dy – zhduket.*

FJALOR:

Shpresa Tokësore: Pritshmëria e fitimit të lumturisë tokësore.

Burrat: Njerëzit me mendje materiale.

I vendosin Zemrat në të: Bëhen marrëzisht të ngjitur me të.

Shndërrohet në Hi: Reduktohet në pluhur nga zjarret e deziluzionimit.

Apo përparon: Përmbushet shkurt.

Si Bora mbi Fytyrën e pluhurosur të Shkretëtirës: Lumturia zbehëse tokësore, që zhduket përballë deziluzionimit.

Duke ndriçuar një Orë të vockël a dy – zhduket: Duke dhënë pak kënaqësi joshëse, pastaj duke u shuar.

15

*As ata që e përdorën me kujdes Grurin e Artë,
As ata që ia hodhën atë Erërave si Shi,
Njësoj, asnjë nuk shndërrohet në Tokë të tillë të praruar
Posa të varrosen, Njerëzit duan të zhvarrosen përsëri.*

FJALOR:

Gruri i Artë: Idhulli i pasurisë.

E përdorën me kujdes: E grumbulluan.

Ia hodhën atë Erërave: E shpenzuan pa karar.

Njësoj: Koprraci dhe harxhuesi i tepërt janë njëjtë të deluzionuar.

Asnjë nuk shndërrohet në Tokë të tillë të praruar: Jo në ar, por në pluhur, shndërrohet argjila e njeriut pas vdekjes.

Posa të varrosen, Njerëzit duan të zhvarrosen përsëri: Ngjitja me jetën materiale e bën njeriun të jetë i etur të kthehet në formën fizike.

16

*Mendo, në këtë Han të stërvjetëruar të karvaneve
Dyert e të cilit janë Nata dhe Dita e njëpasnjëshme,
Si Sulltan pas Sulltani me Pompozitetin e tij
Ndenjën një Orë apo dy, dhe ikën rrugës së vet.*

FJALOR:

Han i stërvjetëruar i karvaneve: Taverna e mjerueshme e kësaj bote, e rrënuar nga stuhitë e përsëritura të pikëllimeve njerëzore dhe katastrofave natyrore.

Dyert e të cilit janë Nata dhe Dita e njëpasnjëshme: Ciklet e përsëritura të jetës dhe të vdekjes, duke na e kujtuar ambientin tonë të panjohur kozmik.

Pompoziteti: Deluzioni i zmadhuar që e pengon njeriun ta pranojë plotësisht faktin se jeta dhe pushteti i tij i tanishëm duhet të përfundojnë me vdekje.

Një Orë apo dy: Jeta e shkurtër e njeriut, kur krahasohet me Përherësinë.

17

Thonë se Luani dhe Hardhuca i ruajnë

Oborret ku Xhemshidi lavdërohej dhe pinte fort;

Dhe Behrami, ai Gjuetar i madh – Gomari i Egër

Shkel fort mbi Kokën e tij, dhe ai bie në gjumë të thellë.

FJALOR:

Luani dhe Hardhuca i ruajnë oborret: Dikur në fund kafshët, nga më e madhja te më e vogla, mbretërojnë mbi rrënojat e monumenteve të thyera njerëzore të triumfit tokësor.

Xhemshidi: Sulltan i famshëm persian; simbol i pushtetit të përkohshëm.

Behrami: Sovran sasanian i Persisë, i njohur për persekutimin mizor të të krishterëve, dhe për aftësinë e tij si gjuetar.

Gomari i Egër shkel fort mbi Kokën e tij: I gjuajturi tallet me gjuetarin, duke e demonstruar paanshmërinë e natyrës, e cila e lejon kohën për ta shkaktuar përmbyshjen e gjithë pushtetit material dhe rrëzimin e krenarisë së vdekshme.

Bie në gjumë të thellë: Pushteti dikur i madh bëhet i pafuqi nga vdekja.

18

*Nganjëherë mendoj se kurrë nuk skuqet kaq shumë
Trëndafili si aty ku i rrodhi gjak njëfarë Cezari të varrosur;
Që secili Zymbyl që e vesh Kopshti
Ra në Prehrin e tij nga një Kokë dikur e këndshme*

FJALOR:

Kurrë nuk skuqet kaq shumë: Kurrë nuk e pasqyron kaq mirë se si gjithë krijimi është i ndërlidhur.

*Zymbyli:*⁶ Mendim fisnik.

Kopshti: Mendja njerëzore.

Koka e këndshme: Shpirti frymëzues.

⁶ Bimë barishtore me zhardhok të vogël, me gjethe të zgjatura si heshtë, me lule të vogla si hinkë e zakonisht të grumbulluara në tufë, në ngjyrë të kaltër, të bardhë, trëndafili etj. dhe me erë të mirë, që lulëzon në fillim të pranverës. (shënim i shqipëruesit nga fjalori shqip-shqip)

19

*Dhe kjo Barishte e lezetshme E Gjelbërta e butë e së cilës
E vesh me pupla Buzën e Lumit në të cilën mbështetemi –
Ah, mbështetu lehtë në të! se kush e di
Nga ajo që dikur ishte Buzë e këndshme buron e padukshmja!*

FJALOR:

Barishte e lezetshme E Gjelbërta e butë e së cilës: Ndjesitë subtile, dhe mendimet e perceptimet që krijohen nga to.

Buza e Lumit në të cilën mbështetemi: Lumi i jetës, që rrjedh nëpër qendrat cerebrospinale (tru-shpinore), nga të cilat varet vitaliteti dhe vetëdija e njeriut.

Mbështetu lehtë në të: Me mprehtësinë e intuitës, shumë më delikate se perceptimi shqisor, përqendrohu në qendrat cerebrospinale të jetës.

Ajo që dikur ishte Buzë e këndshme: Përsosmëria e Zotit e manifestuar në njeriun si shpirt i individualizuar, kaq e këndshme në Burimin e saj para se të zbresë në pakëndshmërinë e shprehjes fizike.

Buron e padukshmja: Nga ky Burim i paparë, rrjedh e gjithë jeta.

20

Ah, I Dashuri im, mbushe Kupën që e pastron

TË SOTMEN e Pishmaneve të së shkuarës dhe të Frikave të së ardhmes –

Nesër? – Epo, Nesër mund të jem

Vetja me Shtatë Mijë Vitet e Së Djeshmes

FJALOR:

I Dashuri: Shpirti; koncepti (shëmbëlltyra) e Zotit në njeriun.

Kupën që pastron: Vetëdija plot lumturi e shpirtit, që e dëbon tërë palumturinë.

Pishmanet e të shkuarës: Pikëllimi për veprimet e këqija tashmë të kryera, dhe rezultatet e tyre të mundshme të tmerrshme.

Frikat e të ardhmes: Ankthi nga përsëritja e veprave të këqija nën ndikimin e ligjit të shprehisë, dhe nga e keqja që do të mund të ndodhte nga keqbërjet e mëtejshme.

Shtatë Mijë Vitet e Së Djeshmes: E shkuara e pafund, që i përfshin të vdekurit e panumërt.

21

*Shih! disa i deshëm, më të këndshmit dhe më të mirët
Atë Kohë dhe Fat të tërë Verës së tyre të shtypur,
E pinë Kupën e tyre një Dolli a dy më parë,
Dhe një nga një u zhytën në Pushim ngadalë.*

FJALOR:

Koha dhe Fati: Vdekja dhe karma (ligji i shkakut dhe efektit).

Verës së tyre të shtypur: Vera e jetës e shtypur nga trupi i vdekshëm.

E pinë Kupën e tyre një Dolli a dy më parë: Kanë vdekur pak para nesh apo shumë më parë.

Të Pushosh: Ta shijosh paqen e jetës së përtejme gjersa e pret një veshje të re të vdekshme.

22

*Dhe ne, që tash kënaqemi në Dhomë
Ata shkuan, dhe Stina e Verës vishet në Lulëzim të ri,
Ne vetë duhet nën Divanin e Tokës
Të zbresim, vetë ta bëjmë një Divan – për kë?*

FJALOR:

Dhoma: Toka, skenë për dramën e jetës.

Stina e Verës vishet në Lulëzim të ri: Vera e një mishërimi të ri i vesh shpirtrat tanë në veshje të freskëta trupore.

Nën Divanin e Tokës të zbresim: Trupi duhet të kthehet në elementet e tokës prej nga erdhi.

Për kë? Lojë me fjalë, me dy kuptime: (1) Ne nuk e dimë eshtrat e kujt në qytetërimet e ardhshme mund të flenë në divanin që e kanë bërë eshtrat tanë. (2) Për kë, apo për çfarë destinimi, vihet në skenë kjo dramë e jetës dhe e vdekjes?

23

*Ah, t'ia nxjerrim yndyrën asaj që mund ta shpenzojmë ende,
Para se edhe ne në Pluhur të zbresim;
Pluhur në Pluhur, dhe nën Pluhur, të shtrihemi,
Pa Verë, pa Këngë, pa Këngëtar, dhe – pa Fund.*

FJALOR:

T'ia nxjerrim yndyrën: Ta kërkojmë të përhershmen, jo të përkohshmen.

Asaj që mund ta shpenzojmë ende: Koha dhe vetëdija e ndërgjegjshme që na kanë mbetur në këtë jetë.

Në Pluhur të zbresim: Të rrëmbehemi nga vdekja.

Pluhur në Pluhur: Trupi i bërë nga toka përzihet me tokën.

Nën Pluhur: Mbetjet tona tokësore do të mbulohen nga pluhuri i brezave të panumërt të të ardhmes, gjatë epokave.

Pa Verë, pa Këngë, pa Këngëtar: Ky trup i vdekshëm nuk do t'i shijojë më kënaqësitë trupore dhe shoqëruesit njerëzorë.

Pa Fund: Cikli i vdekshëm lindje-dhe-vdekje i krijimit vazhdon pa fund, gjersa shpirtrat e lidhur nga ligji i karmës rimishërohen në trupa të rinj, jetë pas jete.

24

*Si për ata që për SOT përgatiten,
Edhe për ata që e shikojnë gjatë TË NESËRMEN,
Një Myezin nga Kulla e Territ klith
“Budallenj! Shpërblimi juaj s’është as Këtu as Atje!”*

FJALOR:

Për SOT përgatiten: Përpiqen ta fitojnë lumturinë materiale tash.

E shikojnë gjatë TË NESËRMEN: Presin ngushëllim tokësor në të ardhmen.

Myezin: Zë i urtisë.

Kulla e Territ: Deziluzionet e jetës nga të cilat mësojmë më në fund.

Shpërblimi juaj: Lumturia e qëndrueshme materiale.

As Këtu as Atje: Nuk do të gjendet as në të tashmen as në të ardhmen.

*Epo, të gjithë Shenjtorët dhe Urtakët që diskutuan
Për Dy Botët me kaq shumë dituri, shtyhen me forcë
Si Profetët budallenj; Fjalët e tyre në Përbuzje
Shpartallohen, dhe Buzët e tyre ndalohen me Pluhur.*

FJALOR:

Dy Botët: Këtu dhe e përtejnjaja.

Profetët budallenj: Urtakët që janë bërë të duken ashtu, kur e predikojnë pavdekësinë e megjithatë u binden ligjeve të ekzistencës së vdekshme.

Fjalët në Përbuzje shpartallohen: Urtia tallet nga ligji i kohës dhe i vdekshmërisë.

Buzët ndalohen me Pluhur: Zërat e të vërtetës heshten me vdekje.

Rubaijat e Omar Khajamit (vetëm vargjet)

1

*Zgjohu! se Mëngjesi në Tasin e Natës
E hodhi Gurin që i nis Yjet në Fluturim:
Dhe Shih! Gjuetari i Lindjes e kapi
Frëngjinë e Sulltanit në një Lak të Dritës.*

2

*Gjersa ëndërroja kur Dora e Majtë e Agut ishte në Qiell
E ndjeva një Zë brenda Tavernës duke klithur:
“Zgjohuni, Të Vegjlit e mi, dhe mbusheni Kupën
Para se të thahet Rakia e Jetës në Kupën e vet.”*

3

*Dhe, gjersa Gjeli këndoi, ata që rrinin
Para Tavernës bërtitën: “Hape pra Derën!
Ti e di sa pak na duhet të rrimë,
Dhe, kur të largohemi, mund të mos kthehemi më.”*

4

*Tash Viti i Ri duke i ringjallur Meraket e vjetra,
Shpirti i zhytur në mendime kalon në Vetmi të Këndshme,
Ku Dora e Bardhë e Musait në Degën Kryesore
Shfaqet, dhe Isai nga Toka psherëtin.*

5

*Irami vërtet është zhdukur me gjithë Trëndafilin e tij,
Dhe Kupa me Shtatë Unaza e Xhemshidit ku askush s'di;
Por prapë Hardhia e jep Rubinin e saj të lashtë,
Dhe prapë një Kopsht skaj Ujit fryn.*

6

*Dhe Buzët e Dautit janë të mbyllura; por në hyjnoren
Pehlevi në fyellin zëhollë, me “Verë! Verë! Verë!
Verë të Kuqe!” – Bilbili i klith Trëndafilin
Atë Faqen e tij të verdhë ta skuqë.*

7

Eja, mbushe Kupën, dhe në Zjarrin e Pranverës

Hidhe Rrobën Dimërore të Pendimit:

Zogu i Kohës ka veç pak rrugë

Të fluturojë – dhe Shih! Zogu është në Krah.

8

Dhe shiko – një mijë Lulëzime me Ditën

U zgjuan – dhe një mijë u shpërhapën në Argjilë:

Dhe ky Muaj i parë i Verës që e sjell Trëndafilin

Do ta largojë Xhemshidin dhe Kaikobadin.

9

Por eja me Khajamin e vjetër, dhe lëre Turmën

E Kaikobadit dhe Kaikhosruit të harruar:

Le të shtrihet Rustumi përreth si të dojë

Ose Hatim Tai le ta qajë Darkën – mos ua vër veshin.

10

*Me mua përgjatë një Rripi të Barishteve të shkapërderdhura
Që veç e ndan shkretëtirën nga të mbjellat,
Ku emri i Skllavit dhe Sulltanit njihet pak,
Dhe Sulltan Mahmudi i shkretë në Fronin e tij.*

11

*Këtu me një Copë Buke nën Degën Kryesore,
Një Shishe me Verë, Një Libër me Vargje – dhe Ti
Pranë meje duke kënduar në Tokë të Egër –
Dhe Toka e Egër është Parajsë e mjaftueshme.*

12

*“Sa i ëmbël që është Sovraniteti i vdekshëm!” – mendojnë disa
Të tjerë – “Sa e bekuar Parajsa që po vjen!”
Ah, merri Paratë në dorë dhe hiq dorë nga Të Tjerat;
Oh, Muzika trime e Daulles së largët!*

13

*Shikoje Trëndafilin që fryn rreth nesh – “Shih,
Unë duke qeshur,” thotë ai, “në Botë fryj:
Menjëherë Xhufka e mëndafshtë e Çantës sime
Shkulet, dhe Thesari i saj hidhet në Kopsht.”*

14

*Shpresa Tokësore në të cilën burrat i vendosin Zemrat
Shndërrohet në Hi – apo përparon; dhe së shpejti,
Si Bora mbi Fytyrën e pluhurosur të Shkretëtirës
Duke ndriçuar një Orë të vockël a dy – zhduket.*

15

*As ata që e përdorën me kujdes Grurin e Artë,
As ata që ia hodhën atë Erërave si Shi,
Njësoj, asnjë nuk shndërrohet në Tokë të tillë të pruar
Posa të varrosen, Njerëzit duan të zhvarrosen përsëri.*

16

*Mendo, në këtë Han të stërvjetëruar të karvaneve
Dyert e të cilit janë Nata dhe Dita e njëpasnjëshme,
Si Sulltan pas Sulltani me Pompozitetin e tij
Ndenjën një Orë apo dy, dhe ikën rrugës së vet.*

17

*Thonë se Luani dhe Hardhuca i ruajnë
Oborret ku Xhemshidi lavdërohej dhe pinte fort;
Dhe Behrami, ai Gjuetar i madh – Gomari i Egër
Shkel fort mbi Kokën e tij, dhe ai bie në gjumë të thellë.*

18

*Nganjëherë mendoj se kurrë nuk skuqet kaq shumë
Trëndafili si aty ku i rrodhi gjak njëfarë Cezari të varrosur;
Që secili Zymbyl që e vesh Kopshti
Ra në Prehrin e tij nga një Kokë dikur e këndshme*

19

*Dhe kjo Barishte e lezetshme E Gjelbërta e butë e së cilës
E vesh me pupla Buzën e Lumit në të cilën mbështetemi –
Ah, mbështetu lehtë në të! se kush e di
Nga ajo që dikur ishte Buzë e këndshme buron e padukshmja!*

20

*Ah, I Dashuri im, mbushe Kupën që e pastron
TË SOTMEN e Pishmaneve të së shkuarës dhe të Frikave të së ardhmes –
Nesër? – Epo, Nesër mund të jem
Vetja me Shtatë Mijë Vitet e Së Djeshmes*

21

*Shih! disa i deshëm, më të këndshmit dhe më të mirët
Atë Kohë dhe Fat të tërë Verës së tyre të shtypur,
E pinë Kupën e tyre një Dollë a dy më parë,
Dhe një nga një u zhytën në Pushim ngadalë.*

22

*Dhe ne, që tash kënaqemi në Dhomë
Ata shkuan, dhe Stina e Verës vishet në Lulëzim të ri,
Ne vetë duhet nën Divanin e Tokës
Të zbresim, vetë ta bëjmë një Divan – për kë?*

23

*Ah, t'ia nxjerrim yndyrën asaj që mund ta shpenzojmë ende,
Para se edhe ne në Pluhur të zbresim;
Pluhur në Pluhur, dhe nën Pluhur, të shtrihemi,
Pa Verë, pa Këngë, pa Këngëtar, dhe – pa Fund.*

24

*Si për ata që për SOT përgatiten,
Edhe për ata që e shikojnë gjatë TË NESËRMEN,
Një Myezin nga Kulla e Territ klith
“Budallenj! Shpërblimi juaj s’është as Këtu as Atje!”*

25

*Epo, të gjithë Shenjtorët dhe Urtakët që diskutuan
Për Dy Botët me kaq shumë dituri, shtyhen me forcë
Si Profetët budallenj; Fjalët e tyre në Përbuzje
Shpartallohen, dhe Buzët e tyre ndalohen me Pluhur.*

Për botimin

Bibliografia

Yogananda, Paramhansa. *Wine of the Mystic — The Rubaiyat of Omar Khayyam: A Spiritual Interpretation*, Self-Realization Fellowship, 1994

Online

<https://botimetrb.wordpress.com/>

Licensimi

Ky publikim lëshohet nën licensën



Attribution-NonCommercial-ShareAlike

CC BY-NC-SA

This license lets others remix, tweak, and build upon your work non-commercially, as long as they credit you and license their new creations under the identical terms.

që nënkupton se i lejon të tjerët ta shkarkojnë dhe ta shpërndajnë te të tjerët, ta ndryshojnë punën në mënyrë jokomerciale, përderisa e përmendin burimin dhe i licencojnë krijimet e reja nën terma identike. Për më tepër, shih:

<http://creativecommons.org/licenses/>